



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i
Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate



INSPEKTORATI
QENDROR I PUNËS

01Nr.1305-91/2025-Gj

Inspektoret e Punës në MFPT-IQP, [REDACTED], e autorizuar sipas dispozitës së nenit 82 dhe 94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitës së nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9, dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.08/L-067 për Inspektimet, në shqyrtim të ankesës me nr. 1133/25, të datës 17.11.2025, të parashtruar nga ankuesja znj. [REDACTED] kundër punëdhënësit GB Solutions L.L.C ,adresa: Rr. "Dardania", p.nr, lidhur me marrëdhënien e punës , me datë 15.01.2026; merr-këtë:

V E N D I M (për shqiptimin e masës ndëshkimore)

Me rastin e inspektimit të kryer sipas ankesës së palës ankuese Znj. [REDACTED] ndaj subjektit GB Solutions L.L.C, me numër unik identifikues 812273514, u konstatua së është përgjegjës për:

- Për cënimin e dispozitës së nenit 10 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, e sanksionuar me dispozitën e nenit 92 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, lidhur me dispozitën e nenit 7 paragrafi 2 pika 2.2 i UA 07/2012, për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete, për Shkeljen e Dispozitave të Ligjit të Punës, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 200.00€ (dyqindë euro).
- Për cënimin e dispozitës së nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës , e sanksionuar me dispozitën e nenit 92 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës,lidhur me dispozitën e nenit 7 paragrafi 2 pika 2.1 i UA 07/2012, për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete, për Shkeljen e Dispozitave të Ligjit të Punës, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 200.00€ (dyqindë euro).

Andaj shqiptohet: masa ndëshkimore në vlerë prej 400.00€ (katërqindë euro).

Obligohet personi juridik që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i këtij Vendimi, për gjobën e shqiptuar ta merr UNIREF-in në zyrat e Inspektoratit të Punës dhe të paguaj në llogarinë bankare [REDACTED] duke u thirrur në numrin e këtij Vendimi. Dëftesa për kryerjen e pagesës merret në zyre të Inspektoratit të Punës objekti "Qendra Transite Postare", kati 1, Zona Industriale Prishtinë.

Kopja e pagesës, në momentin e kryerjes së obligimit, duhet t'i prezantohet Inspektorëve të Punës, ose të dërgohet në adresë objekti "Qendra Transite Postare", kati 1, Zona Industriale Prishtinë, në të kundërtën do të iniciohet procedurë përmbarimore.

Arsyetim

Më datë 09.01.2025, është kryer inspektimi, sipas parashtrës së ankueses [redacted] e cila ka pretenduar se punëdhënësi nuk i ka ofruar kontratë të punës dhe nuk e ka lajmëruar në ATK, si dhe nuk i'a ka kompensuar për punën e kryer në vlerë prej 90 euro. Inspektorët e punës me datë 09.01.2026 kanë kryer inspektim në subjektin si në preambulë të raportit, me çrast punëdhënësi nuk prezantoi kontratën e punës, dëshmi se ankuesja është lajmëruar në Administratën Tatimore të Kosovës si dhe nuk prezantoi kompensimin në emër të pagës në vlerë prej 90 euro. Punëdhënësit i është dhënë afatë që deri më datë 13.01.2026, të prezantoi kontratën e punës, dëshmi se ankuesja është lajmëruar në ATK dhe të kryej obligimin në emër të pagës në vlerë prej 90€, sipas pretendimit të ankueses. Punëdhënësi edhe pas këtij afati nuk ka arritur të prezantoi dokumentacionin e kërkuar, konkretisht kontratën e punës dhe dëshmi se ankuesja është lajmëruar në atk, me përjashtim të pagës në vlerën e theksuar më lartë. Andaj bazuar në atë që u tha më lartë punëdhënësi ka bërë shkelje të nenin 7.4 dhe 10 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë, punëdhënësi ka bërë shkelje të nenit 7.4 dhe 10 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Inspektore e Punës

[redacted]
[Signature]

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi lejohet ankesë në afat prej 30 ditësh, në Komisionin e Ankesave të Inspektoratit Qendror të Punës, nëpërmes Inspektoratit të Punës në Prishtinë, Rr." Azizë Abrashi", p.n, "Objekti Qendra Tranzite Postare, Zona Industriale Prishtinë - Fushë Kosovë".

Pranuar 15.01.2026, [redacted]
[Signature]